Republika e Shqiperise
Bashkia Elbasan
Keshilli Bashkiak

Adresa:Bashkia Elbasan, Rruga"11 Nentori",tel:003555452797, fax:003555452246, e-mail: Bashkiaelb@yahoo.com

Nr 41 Prot. Elbasan, 24/02/2012

# VENDIM

Nr. 10, date 22-02-2012

*Mbi*

***"Raportin financiar te ekspertit kontabel te autorizuar lidhur me dhurimin e aksioneve ndermjet aksionereve te shoqerise Futboll Klub Elbasani".***

Keshilli Bashkiak, ne mbledhjen e dates 23.02.2012, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga eksperti kontabel i pavarur z.Agim Qinami "Mbi Raportin financiar te ekspertit kontabel te autorizuar lidhur me dhurimin e aksioneve ndermjet aksionereve te shoqerise Futboll Klub Elbasani", bazuar ne nenin 32, te ligjit Nr 8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore",

**Vendosi:**

1. Te miratoje ne parim dhurimin e aksioneve Bashkise Elbasan nga aksioneret e shoqerise Futboll Klub Elbasani dhe konkretisht nga aksioneri Arben Laze 1.815% te aksioneve, nga aksioneri Genti Cerraga 13.485% te aksioneve.
2. Pas dhurimit raporti i aksioneve te kesaj shoqerie ndryshon si me poshte;
    1. Arben Laze nga 47.775% behet 45.96% (dhuron 1.815%)
    2. Genti Cerraga nga 22.175% behet 8.69% (dhuron 13.485%)
    3. Bashkia Elbasan nga 30.05% behet 45.35%
3. Pas kryerjes se procedurave keto ndryshime te pasqyrohen ne dokumentat e shoqerise.
4. Ngarkohet me zbatimin e ketij vendimi Kryetari i Bashkise.
5. Ky vendim hyn ne fyqi 10 dite pas shpalljes.

**Sek K. Bashkiak**
**Reshit Haxhihyseni**

**Kryetari**
**Blendi Himci**
**Me porosi**
**N/kryetari**
**Kujtim Hazbiu**

Republika e Shqiperise
Bashkia Elbasan
Keshilli Bashkiak

Adresa:Bashkia Elbasan, Rruga"11 Nentori",tel:003555452797, fax:003555452246, e-mail: Bashkiaelb@yahoo.com

Nr 16 Prot. Elbasan 28/01/2011

# VENDIM

Nr. 3, date 24-01-2011

***"Dhenie autorizimi Kryetarit te Bashkise Z.Qazim Sejdini, per te perfaqesuar bashkine si aksionere e F.K. Elbasanit sh.a.".***

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 24.01.2011, pasi shqyrtoi kerkesen e Kryetarit te Bashkise, drejtuar ketij keshilli, ne lidhje me dhenien e autorizimit, si pefaqesues ligjor kryetarit te bashkise per te perfaqesuar Bashkine Elbasan si aksionere e Futboll Klub Elbasanit sh.a. ne QKR, Ligji nr 8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 44, 32 :

Vendim

1. Dhenie autorizimi Kryetarit te Bashkise Z. Qazim Sejdini, per te perfaqesuar Bashkine Elbasan, si aksionere e Futboll Klub Elbasanit sh.a.
2. Te rivleresohen kapitalet e bashkise ne kete shoqeri, duke konsideruar financimet e kryera deri me tani nga bashkia.
3. Te raportohet ne keshill gjendja ekonomike e financiare e shoqerise sipas bilanceve vjetore.
4. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi kryetari dhe administrata e Bashkise.
5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i K. B
Reshit HAXHIYSENI

Kryetari
Eugen ISAJ

FUTBOLL KLUB ELBASANI
SOCCER CLUB ELBASANI
REPUBLIKA E SHQIPERISE– REPUBLIC OF ALBANIA

Bulevardi "Qemal Stafa"
Stadiumi "Ruzhdi Bizhuta"
Elbasan, Albania
Tel/Fax. +3555453253
www.fkelbasani.al
e-mail. info@fkelbasani.al

VENDIM I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE SHOQERISE
"F.K. ELBASANI" SH.A

Sot me date 04/05/ 2016, Asambleja e Aksionereve te Shoqerise "F.K.ELBASANI" SH. A e perbere nga Bashkia Elbasan perfaqesuar nga Z.Qazim Sejdini, Z. Arben Laze, Z. Gentian Cerraga te cilet zoterojne perkatesisht 45.35 %, 45.96 % dhe 8.69 %;

**KONSTATOI**

Se shoqeria **"F.K. ELBASANI" SH.A** eshte regjistruar si person juridik me vendimin e gjykates se rrethit gjyqesor Tirane me dt.28.01.2004 dhe regjistruar me NIPT K42528205S. Duke iu referuar ketyre akteve rezulton se kjo Shoqeri ka aksionere te saj Bashkia Elbasan, Arben Laze, dhe Gentian Cerraga te cilet zoterojne perkatesisht 45.35 %, 45.96 % dhe 8.69 % te aksioneve te nenshkruara te shoqerise.

Asambleja e Aksionereve mori ne shqyrtim rendin e dites keto pika:

1. Miratimi i shitjes se aksioneve te zoteruara nga aksioneri Genti Cerraga Bashkise Elbasan.

Mbasi u diskutuan ceshtjet e rendit te dites ne baze te baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", konstatohet se aksioneri Gentian Cerraga deshiron te shese aksionet e tij dhe Bashkia Elbasan deshiron ti bleje. Aksioneret pranojne qe te kryhet ky transaksion i shitblerjes se aksioneve ndermjet ketyre dy paleve. Ne perfundim asambleja e aksionereve:

**VENDOSI**

1. Te behet shitja e aksioneve nga aksioneri Gentian Cerraga per aksionerin Bashkia Elbasan.
2. Kapitali i shoqerise mbas kesaj shitje mbetet 92.437.000 leke dhe zoterohet nga aksioneret si vijon:
   - Aksioneri Arben Laze zoteron 45.96% te aksioneve ose 42.484.045 leke.
   - Aksioneri Bashkia Elbasan zoteron 54.04% te aksioneve ose 49.952.955 leke.
3. Aksioneri Gentian Cerraga largohet.

**ASAMBLEJA E AKSIONEREVE**

| Bashkia Elbasan<br>Perf.nga Kryetari<br>Qazim Sejdini , | Arben Laze | Gentian Cerraga |
|---|---|---|
| | | |

S.H.A ELBASANI ALBANIA

Gentian Cërraga

# KONTRATE SHITJE E AKSIONEVE TE SHOQERISE

Sot me date 04/05/2016 ne palet e meposhteme vendosëm perpilimin e kesaj kontrate shitje pjesesh:

## PALA SHITESE

Zoti Gentian Cerraga, qytetar shqiptar, lindur ne Elbasan me date 05.05.1970, dhe banues ne Elbasan, Lagja Dyli Haxhire titullar i pashaportes me nr Z1869084.

## PALA BLERESE

Bashkia Elbasan e perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise Zoti Qazim Sejdini.

Te gjithe jane madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me vullnet të plotë kërkuan përpilimin e kësaj kontrate:

## PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Pala shitëse e aksioneve te kapitalit është aksioner në shoqërinë "Futboll Klub Elbasan" sh.a. e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqipëtar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër Nipti K42528205S.
Kapitali themeltar i shoqërisë "Futboll Klub Elbasan" sh.p.k është 92.437.000 lekë.
Pala shitëse Z. Gentian Gerraga zoteron aksionet e shoqerise qe perfaqesojne 8.69 % te kapitalit te regjistruar te saj.

## NENI 1
## OBJEKTI I KONTRATËS

Pala shitëse Z. Gentian Cerraga, i shet bleresit Bashkia Elbasan aksionet nga kapitalit qe ai zoteron dhe qe eshte sa 8.69 % e kapitalit te regjistruar, ose me vlere 8.032.775,30 leke.

## NENI 2
## ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

Për blerjen e kuotes të shoqërisë, objekt i kësaj kontrate, Blerësi Bashkia Elbasan ka detyrim t'i paguajë shitësit shumën totale prej 8.032.775,30 leke.

## NENI 3
## TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. E drejta e pronësisë mbi aksionet e palës shitëse, i kalon palëve blerese në momentin e nënshkrimit të kontratës.
2. Pala shitëse i dorëzon palës blerëse të gjitha dokumentat, deklaratat, ose çertifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të aksioneve të kapitalit themeltar në favor të palës blerese dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qëndrës Kombëtare të

Regjistrimit. Në momentin e transferimit të kupotes palës blerëse, ajo bëhet zotëruese e 54.04 % kapitalit themeltar të shoqërisë me nje vlere prej 49.952.955 leke.

## NENI 4
## DEKLARATA DHE GARANCI

Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse për sa më poshtë vijon:

1. Pala shitëse është pronare e ligjshme e aksioneve që i shet palës blerëse, e cila eshte plotësishte nënshkruar dhe e paguar;
2. Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklaratat e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifat dhe detyrime të tjera shtetërore për shoqërinë, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;
3. Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marveshjeje me te cilën është palë;
4. Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për shitjen e pjesëve të kapitalit themeltar.

## NENI 5
## DETYRIMET TATIMORE

Pala blerëse pranon të përfitojë aksionet e kapitalit si më sipër, me gjendjen e aktivit dhe pasivit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

## NENI 6
## KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqipëtar.
Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë , ose çdo marrëveshje tjetër me mirëkuptim midis palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis paleve.
Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njërës nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të cënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërine e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje ligjërisht të vlefshme, që korrespodon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

## NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt nëse i dorëzohen në dorë, i dërgohen me postë të rregjistruar ose me faks palës në adresën e paracaktuar nga palët.

**DISPOZITA E FUNDIT**

Kjo kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe me të njëjtën vlerë secila, në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil ( të ndryshuar) si edhe të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**PALËT**

| | |
|---|---|
| **PALA SHITESE** | **PALA BLERESE** |
| Gentian Cerraga | Bashkia Elbasan |
| | Perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise |
| | Qazim Sejdini |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN -

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**

**Nr.** 3 07/1 **Prot.**

**Elbasan më** 28.2.**2017**

**Lënda:** *Konfirmim Akti*

***Drejtuar:*** **KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.18 datë 23.02.2017 "Për një ndryshim në VKB nr.96 dt.08.09.2016", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Arben KAMAMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa" Tel.054252138, Fax.054252446

381

27.2.2017

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA ELBASAN

Keshilli Bashkiak

Adresa:Bashkia Elbasan,Rr. Qemal Stafa",Tel.+355 54 400152,E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

**Nr 43 Prot** **Elbasan 27.02.2017**

**Vendim**

**Nr 18 Date 13.02.2017**

**"Per nje ndryshim ne VKB nr 96, date 08/09/2016"**

Keshilli Bashkiak, ne mbledhjen e tij te dates 13.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkise, ne lidhje me kerkesen e "MANCHESTER GROUP", per blerjen e aksioneve te Bashkise ne shoqerine FK Elbasani sh.a, bazuar ne ligjin 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", neni 9 e 54 te tij, ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

**Vendosi**

1- Te miratoje ne parim shitjen e aksioneve qe Bashkia zoteron ne shoqerine KF Elbasani sh.a, shoqerise "MANCHESTER GROUP" (referuar me pare Level Up SA).

2- Per shqyrtimin, vleresimin e ofertes se paraqitur si dhe realizimin e procedurave te shitjes se ketyre aksioneve, te ngrihet i njejti komision i perkohshem i keshillit bashkiak i perbere sipas VKB 96, date 08/09/2016

3- Ngarkohet Kryetari i Bashkise qe pas shqyrtimit te raportit te hartuar nga komisioni, dhe ne varesi te konkluzioneve te dhena prej tij, te negocioje me shoqerine "MANCHESTER GROUP" dhe te nenshkruaje aktet perkatese per realizimin e shitjes se aksioneve.

**Konceptoi:**

**Zv/Kryetari i Bashkise:**

**K.Xhoxhi**

**Sek K.Bashkiak**

**Klajd Gripshi**

**Kryetari**

**Altin Idrizi**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr...707....Rep
Nr...292.....Kol

**KONTRATË SHITJE AKSIONESH**

Në Tiranë sot më date 01/03/2017, para meje noteres Ardjana A.MEDIU, me seli në adresën: Blv."Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kat 7- Tiranë, u paraqit personalisht:

**Z.Qazim Sejdini**, Kryetar i Bashkise Elbasan, ne cilesine e Perfaqesuesit te Bashkise Elbasan, i dtl 12.02.1951, lindur dhe banues ne Elbasan, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar per meje me leternjoftim, ID nr.personal F10212102C.

Dhe
Shoqeria "MANCHESTER GROUP", e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me NIPT L71427014A, e përfaqësuar nga **Z.Bradley Videgeon**, dtl.18.07.1953, lindur ne Mandeville dhe banues ne Londer, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaporte Britanike me numër personal 522605880 dhe **Z.Michael Yiu Chung Stubbs**, dtl.09.03.1964, lindur ne Hong Kong dhe banues ne Londer, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaporte Britanike me numër personal 801229545.

Duke konsideruar që,
Palët, bazuar në parashikimet e Statutit të Shoqërisë dhe të Ligjit Shqiptar Nr.9901, dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord të rregullojnë me këtë kontratë, shitjen e 54 (pesedhjete e kater) % të aksioneve te shoqerise "F.K ELBASANI" SH.A tek Shoqeria "MANCHESTER GROUP", në përputhje me nenet vijuese:

**SALE OF SHARES CONTRACT**

Today on 01/03/2017, in front of me Notary Public Ardjana A.MEDIU, with address: Blv."Deshmoret e Kombit", Twin Towers, 7-th floor, Tirana, was personally presented:

**Mr.Qazim Sejdia**, Mayor of Elbasan, in the quality of the representative of the Municipality of Elbasan, born on 12.02.1951, in Elbasan and resident in Elbasan, adult with full legal capacity to act, holder of ID card with Personal number F10212102C.

And
The company "MANCHESTER GROUP" registered with the National Center of Business, with fiscal code L71427014A, represented by **Mr. Bradley Videgeon**, born on 18.07.1953, in Mandeville and resident in London, adult, with full legal capacity to act, holder of British Passport with number 522605880 and **Mr. Michael Yiu Chung Stubbs**, born on 09.03.1964, in Hong Kong and resident in London, adult, with full legal capacity to act, holder of the British Passport with personal number 801229545.

Considering that,
The parties, based on the provisions of the Articles of incorporation of the company and the Albanian Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On merchants and commercial companies" agree to regulate with this contract the formal transfer and registration of 54% of shares of the company "F.K Elbasani" SH.A to "MANCHESTER GROUP" in compliance with the following articles:

**Neni 1**
**Palët kontraktore**

Bashkia Elbasan, person juridik publik, ne kuptim te ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore" e cila eshte pronare e 54 % te aksioneve te shoqerise "F.K.Elbasan" SH.A, e perfaqesuar nga **Z.Qazim Sejdini**, Kryetar i Bashkise Elbasan, ne cilesine e perfaqesuesit te Bashkise Elbasan ne marredheniet me te tretet, ne mbeshtetje te ligjit Nr.139/2015 "Per Qeverisjen Vendore" neni 64, pika "gj", i dtl 12.02.1951, lindur dhe banues ne Elbasan, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar per meje me leternjoftim, ID nr.personal F10212102C, nga këtu e në vijim referuar si **"Shitësi".**

Shoqeria **"MANCHESTER GROUP",** e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me NIPT L71427014A, e përfaqësuar nga **Z.Bradley Videgeon**, dtl. 18.07.1953, lindur ne Mandeville dhe banues ne Londer, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaporte Britanike me numër personal 522605880 dhe **Z. Michael Yiu Chung Stubbs**, dtl.09.03.1964, lindur ne Hong Kong dhe banues ne Londer, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Pasaporte Britanike me numër personal 801229545, nga këtu e në vijim referuar si **"Blerësi".**

**Neni 2**
**Objekti i kontratës**

Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi tek Blerësi i 54 (pesedhjete e kater) % të akioneve të Shoqërisë "F.K.Elbasan" SH.A, Shoqeri Tregtare Shqiptare, e regjistruar me dt. 28.01.2004, me NIPT-K42528205S, me adrese, Elbasan Stadiumi "Ruzhdi Bishuta", qe jane aktualisht ne pronesi te Shitesit, si dhe regjistrimi formal i kesaj transferte ne Regjistrin Tregtar Shqiptare dhe ne Regjistrin e Posaçem te Aksioneve te vete shoqerise "F.K.Elbasan" SH.A, ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare" (neni 117/2 dhe 119).

**Article 1**
**Contracting parties**

Municipality of Elbasan, public legal person within the meaning of Law 139/2015 "On Local Self-Government" which is the owner of 54% of the shares of the company "F.K. Elbasan" SH.A, represented by **Mr. Qazim Sejdini**, Mayor of Elbasan, in his capacity as representative of Municipality of Elbasan in relation with third parties, pursuant to law no. 139/2015 "on Local Self-Government", Article 64, paragraph "gj", born on 12.02.1951, in Elbasan and resident in Elbasan, adult with full legal capacity to act, holder of ID card with personal no. F10212102C, hereinafter referred to as **"The Seller"**.

**The company "MANCHESTER GROUP"** registered with the National Center of Business, with fiscal code L71427014A, represented by **Mr. Bradley Videgeon**, born on 18.07.1953, in Mandeville and resident in London, adult, with full legal capacity to act, holder of the British Passport with number 522605880 and **Mr. Michael Yiu Chung Stubbs**, born on 09.03.1964, in Hong Kong and resident in London, adult, with full legal capacity to act, holder of the Passport with number 801229545, hereinafter referred to as **"The Buyer"**.

**Article 2**
**Object of the contract**

The object of the contract is the sale from the Seller to the Buyer of 54% (fifty-four percent) of shares of the company "F.K. Elbasan" SH.A, Albanian Commercial Company, registered on 28.01.2004, with fiscal code K42528205S, with address: Elbasan Stadium "Ruzhdi Bishuta ", which are currently owned by the Seller, as well as the formal registration of this transfer with the Albanian Commercial Register and in the special register of its own shares of the company "F.K.Elbasan" SH.A, pursuant to the Law No.9901, dated 14.04.2008 "On Merchants and Commercial Companies" (article 117 / 2 and 119)

**Neni 3**

**Cmimi i blerjes**

Cmimi per shitjen dhe transferimin formal vijues te 54 % te aksioneve (54 aksione me te drejte vote) te Shoqerise "F.K.Elbasani" SH.A, eshte si me poshte :

- Numri i aksioneve qe shiten nga Shitesi (Bashkia Elbasan) tek bleresi eshte 54% te aksioneve me te drejte vote.
- Cmimi i nje aksioni eshte 924.370 leke.
- Cmimi total i kontrates eshte 54 x 924.370=49.915.980 (dyzete e nente milion e nenteqind e pesembedhjete mije e nenteqind e tetedhjete) leke.
- Cmimi i mësipërm, i nevojshëm për regjistrimin formal të kësaj kontrate në Regjistrin Tregtar Shqiptar, do te paguhet nga bleresi me transferte bankare ne llogari te shitesit ne "Banka Kombetare Tregtare" SH.A brenda nje afati kohor prej 100 (njeqind) ditesh, afat i cili fillon ne date 28.02.2017.
- Pronesia mbi aksionet, per palen blerese, fillon menjehere pas pageses se plote te shumes se mesiperme.
- Ne rast se detyrimi i pales blerese per pagesen e shumes se mesiperme, nuk do te paguhet brenda ketij afati, kjo kontrate do te konsiderohet e zgjidhur dhe palet do te kthehen ne gjendjen e meparshme.

**Article 3**

**Purchase price**

The price for the sale and the successive formal transfer of 54% of shares (54 shares with voting rights) of the company "F.K. Elbasani" SH.A, is as follows:

- The number of the shares that will be sold from the Seller (Municipality of Elbasan) to the Buyer is 54% of the shares with voting rights
- The price for one share is 924.370 ALL (nine hundred twenty four thousand and three hundred seventy).
- The total price of the contract is 54 x 924.370=49.915.980 ALL (forty nine million nine hundred fifteen thousand and nine hundred eighty)
- The abovementioned price, necessary for the registration of this contract with the Albanian Trade Register will be paid by the purchaser by bank transfer to the account of the seller in "Banka Kombetare Tregtare" SH.A within a time frame of 100 (one hundred) days, time which commences on 28.02.2017.
- The ownership on the shares for the buyer starts immediately after the full payment of the abovementioned sum.
- In the event that the purchasing party's obligation for the payment of the abovementioned sum, will not be liquidated within this period, this contract will be considered canceled and the parties will return to the previous situation.

**Neni 4**

**Detyrimet dhe garancitë e palëve**

- Bleresi do te ruaje te pandryshuar simbolet e ekipit te futbollit dhe konkretisht:

  Emrin aktual te ekipit te futbollit **"ELBASANI"**

  Stemen e ekipit, sipas stemes aktuale.

  Ngjyra e fanelles se ekipit: **Portokalli dhe Blu.**

**Article 4**

**Obligations and guarantees of the parties**

- The buyer will keep unchanged the football team symbols, namely:

  The actual name of the football team "Elbasani"

  Emblem of the team, as it is currently.

The color of the shirt of the team: **Orange and Blue.**

The buyer shall repay all obligations to third

- Bleresi do te shlyeje te gjitha detyrimet ndaj te treteve (privat dhe shteteror), qe rendojne mbi shoqerine "F.K.Elbasani" sha, te dokumentuara nga vendimet gjyqesore, si dhe nga njoftimet e Drejtorise Rajonale te Tatimeve.

Shitësi garanton se aksionet objekt i kësaj kontrate nuk jane objekt i ndonjë pengu, sigurimi, barre apo mjeti tjetër sigurimi dhe se është vetëm Shitësi i cili ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive mbi kuotën.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga e drejta e 54% e aksioneve objekt kontrate, të drejta të cilat i transferohen Blerësit.

Shitësi do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar përfundimin e kësaj kontrate dhe do të zbatojë/respektojë të gjitha detyrimet që lidhen me këtë.

Blerësi do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të garantuar pjesën e tij të përfundimit të kësaj kontrate dhe zbatojë/respektojë të gjitha detyrimet që lidhen me këtë.

**Neni 5**

**Neni i fundit**

Sa më sipër u redaktua prej meje noteres, iu lexua paleve dhe si u gjet konform vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht para meje noteres.

**SHITËSI**

**Përfaqësuar nga**

**BLERËSI**

**Përfaqësuar nga**

parties (private and state), that burden on the company "F.K.Elbasani" SH.A, documented by court decisions, as well as by reports of Regional Tax Directorate.

The Seller warrants that the shares subject to this contract are not subject to any pledge, security, lien or other security instrument and that is only the Seller who has the full and exclusive right over the shares.

By signing this contract, the Seller waives the right to 54% of the shares subject to this Agreement, rights which are transferred to the Buyer.

The Seller shall take all steps necessary to ensure the completion of this contract and will implement / comply with all obligations related to this obligation.

The Buyer shall take all steps necessary to ensure the completion of this contract and will implement / comply with all obligations related to this obligation.

**Article 5**

**Last article**

The above was prepared by me the notary, was read to the parties and after it was found in conformity to their free and full will, was regularly signed in front of me the notary.

**THE SELLER**

**Represented by Mr.**

**THE BUYER**

**Represented by**

BRADLEY M. VIDEZON

MICHAEL STUBBS

NOTERE / NOTARY

Ardjana A.MEDIU

**"F.K ELBASANI" SHA**
**NIPT K42528205S**

**Vendim Nr. ________**

**VENDIM I ASAMBLESË**
**SË**
**AKSIONARËVE TË SHOQËRISË**

Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë **"F.K ELBASANI" SHA** me nr. NIPT K42528205S, e thirrur nga Administratori i saj **Z. Florenc Kushi**, zhvilloi mbledhjen e saj sot më datë 02.08.2017, ora 11.00 në adresën: Stadiumi "Ruzhdi Bizhuta", Elbasan, me rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i shitjes së aksioneve të zotëruara nga aksionari Z. Arben Laze, të cilat përfaqësojnë 46% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "F.K ELBASANI" SHA. Këto aksione do t'i shiten aksionarit të shoqërisë, shoqërisë "Manchester Group" SHPK.

Aksionarët e shoqërisë të pranishëm në mbledhje janë:

- **Z. Arben Laze,** zotërues i 46 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë.
- Shoqëria **"Manchester Group" SHPK** zotëruese e 54 % të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga **Z. Michael Yiu Chung Stubbs.**

Pasi u mor në shqyrtim çështja e rendit të ditës, u konstatua se janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe dispozitat e statutit të shoqërisë lidhur me procedurën e thirrjes së mbledhjes së asamblesë dhe pjesëmarrjen e aksionarëve, dhe se çështja e rendit të ditës bën pjesë në kompetencat e Asamblesë së shoqërisë, sikurse është përcaktuar në Statutin e shoqërisë si dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe për këtë arsye, në përfundim të diskutimeve, Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë "F.K ELBASANI" SHA, unanimisht,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shitjes së aksioneve të zotëruara nga ortaku Z. Arben Laze, të cilat përfaqësojnë 46% të kapitalit themeltar të Shoqërisë "F.K ELBASANI" SHA. Këto

aksione do t'i shiten aksionarit të shoqërisë, shoqërisë "Manchester Group" SHPK.

**Shoqëria "F.K ELBASANI" SHA pas realizimit të transaksioni shit-blerje aksionesh, sipas kontratës përkatëse do të ketë si aksionarë të saj të vetëm shoqërinë "Manchester Group" SHPK.**

Duke qënë se nuk kishte më çështje për të diskutuar, mbledhja konsiderohet e mbyllur dhe aksionarët nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë e të pa vesuar Vendimin e mësipërm

**AKSIONARËT E SHOQËRISË "F.K ELBASANI" SHA**

**Z. Arben Lazaj**

**Për shoqërinë "Manchester Group" SHPK**
**Z. Michael Yiu Chung Stubbs.**

Asistuar nga Z. Plarent Ruka
Njohës i gjuhës angleze

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 2817 **Rep**
**Nr.** 972 **Kol**

## KONTRATË

## SHIT – BLERJE AKSIONESH

Sot, më 03/08/2017, përpara meje noteres Ardjana A. Mediu, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr. 2, Tiranë, u paraqitën personalisht Shitësi dhe Bleresi, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate Shit-Blerje Aksionesh, me termat e mëposhtme:

*E lidhur ndërmjet palëve:*

I. **Arben Laze,** i biri i Saliut, lindur në Përmet më 13.06.1968 e banues në Lagjen "Viserion Xhuvani", Pall. 496, Elbasan, identifikuar me letërnjoftimin nr. 030280733, këtu e në vijim **"Shitësi".**

II. **Shoqëria "Manchester Group" SHPK**, person juridik shqiptar, identifikuar me NUIS L71427014A , regjistruar në datën 27.02.2017 me seli në Rrugën "Themistokli Gërmenji", Pallati i firmes Atane TCI, Ambasador 1, Zyra Kati 1, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë përfaqësuar nga Administratori i saj z. Michael Yiu Chung Stubbs, Shtetas Anglez, lindur në Hong Kong më 09.03.1964, identifikuar me Pasaportën Nr. 801229545, këtu e në vijim **"Bleresi"**.

III. **Federata Shqiptare e Futbollit,** person juridik Shqiptar, regjistruar me vendimin nr. 9 datë 31.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë Rr "Elbasanit" Nr. 9, përfaqësuar nga Presidenti Zoti Armand Duka, lindur në Shijak më 07.10.1962 dhe banues në Durrës, identifikuar me letërnjoftimin Nr. 028820553, këtu e në vijim **"FSHF"**

Bashkërisht referuar si "**Palët**";

## Kushtet Paraprake

Shitësi është aksionar i shoqërisë "F.K EKBASANI" SHA, regjistruar më 28.01.2004, me seli në Elbasan, Stadiumi "Ruzhdi Bizhuta" me NUIS K42528205S, zotërues i 46 aksioneve me vlerë nominale 42.521.020 Lekë ose 46% të kapitalit.

Meqenëse aksionet objekt kontrate janë nën sekuestro nga Banka Raiffeisen, e cila kërkon paraprakisht shlyerjen e kredisë së marrë nga Shitësi për zhbllokimin e tyre;

Meqenëse FSHF, si autoriteti më i lartë i futbollit të organizuar në vend, ka interes të ndihmojë FK ELBASANI të dalë nga situata e vështirë ekonomike, pranon të veprojë si garantues, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara më poshtë;

**Neni 1**

Kushtet Paraprake përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate.

**Neni 2**

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi i shet aksionet që zotëron në shoqërinë "KF ELBASANI" SHA, kundrejt çmimit të parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate, Blerësit, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

**Neni 3**

**3.1** Çmimi i shitjes së 46% të aksioneve të shoqërisë "KF ELBASANI" SHA, është me vlerën nominale prej 499.000 Euro (katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë Euro).

**3.2** Për efekt të zhbllokimit të aksioneve të shitësit, FSHF do të paguajë në favor të Raiffeisen Bank një vlerë prej 130.000 Euro (njëqind e tridhjetë mijë Euro), që përbën çmimin e kredisë të negociuar midis shitësit dhe Bankës;

**3.3** Kjo shumë do t`i rimbursohet FSHF nga Blerësi në llogarinë e FSHF me të dhënat e mëposhtme brenda 30 ditëve pune nga heqja e masës së sekuestros mbi aksionet:

Federata Shqiptare e Futbollit
Banka: Union Bank SHA
IBAN:
- ALL: 15 2141 1106 0111 1416 2802 0115
- EUR: 09 2141 1106 0111 1416 2802 0126

3.4 Në rast mos përmbushjeje të detyrimit brenda afatit të parashikuar në nenin 3.3, këtu më sipër, shitësi detyrohet të kthejë menjëherë shumën e financimit të lëvruar nga FSHF konform Nenit 3.2 të kësaj marrëveshjeje;

3.5 Në rast të mos rimbursimit të vlerës sipas pikës 3.3 të këtij neni blerësi detyrohet ti paguajë FSHF-së përveç detyrimit kryesor edhe një kamatë ligjore në masën e interesit të Bankës së Shqipërisë për çdo ditë vonesë.

3.6 Kjo kontratë përbën titull ekzekutiv ne kuptim te Nenit 510 dhe vijues te Kodit të Procedurës Civile.

3.7 Diferenca e çmimit të shitjes në masën 369.000 Euro (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë Euro) do të likuidohet nga Blerësi kundrejt Shitësit, në llogarinë bankare të këtij të fundit brenda **45 (dyzet e pesë)** ditësh pune nga heqja e barrës mbi aksionet.

### Neni 4

4.1 Me shitjen e këtyre kuotave, përbërja e ortakëve në shoqërinë "F.K ELBASANI" SHA ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

1. ***Manchester Group SHPK*** *zotëron 100 aksione me vlerë nominale 924.370 Lek ose 100% të kapitalit prej 92.437.000 lek.*

4.2 Me realizimin e kësaj shitblerje të 46% e aksioneve të shoqërisë "KF ELBASANI"SHA, Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre, dhe në të njëjtën kohë fiton cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja si aksioner i shoqërisë duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet e shitura.

4.3 Pronësia e aksioneve transferohet nga shitësi tek blerësi pas pagesës së çmimit në përputhje me nenin 3 të kësaj kontrate.

### Neni 5

5.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi aksionet që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme përveç atyre të cituara në Kushtet Paraprake të Kontratës; ia shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to nuk janë të përfshira në procese civile,

penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloj natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

**NENI 6**

6.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

6.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë në gjuhën shqipe, nga të cilat nga një kopje mbahet nga palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrit Tregtar, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje depozitohet pranë zyrës noteriale në të cilën u redaktua.

Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje noterit, ju lexuan palëve kontraktuese, të cilët e nënshkruajnë atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në prezencën time.

**PALËT KONTRAKTORE**

**SHITËSI, ARBEN LAZE** Arben Laze ________________

**BLERËSI, MANCHESTER GROUP SHPK** MICHAEL STUBBS ________________

**FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT** Armand Duka ________________

**Në prani të përkthyesit të Gjuhës Angleze**

**Dr. Plarent Ruka** Plarent Ruka ________________

**NOTERE**

________________